

SPECIFIKIME TEKNIKE

“PROJEKTE MODEL” PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, ME KOSTO TË ULËT DHE EFIÇENCË ENERGJIE

Ndërtesat e lehta parafabrikatë, në varësi të përdorimit, mund të aplikohen në çdo lloj kompozimi në plan, për sa kohë përmasat janë shumëfishë të 125 cm. Këto lloj strukturash janë të projektuara për t'u montuar dhe çmontuar disa herë sipas nevojave. Të gjithë materiale e përdorura janë të certifikuara sipas TSE.

Struktura mbajtëse është profil H çeliku i galvanizuar. Muret e jashtme kanë trashësi 10 cm dhe përbëhen nga dy panele fibër-çimento klasi A1, dhe shtresë termoizolimi EPS 8 cm, klasi B1. Muret e brendshme kanë trashësi 8 cm dhe përbëhen nga dy panele fibër-çimento klasi A1, dhe një shtresë termoizolimi EPS 4 cm, klasi B1. Tavani është i përbërë prej gipsi dhe një shtresë izoluese 8 cm. Çatia është e përbërë prej një konstruksioni me sistem kapriatë me profile çeliku 0.8-2.0 mm, me intervale 125 cm. Mbulesa e çatisë është prej flete çeliku të galvanizuar me trashësi 0.45 mm. Ndërtesa fiksohet në themelin e betonit të përforcuar me hekur apo çelik.

TË DHËNA TEKNIKE

Ndërtesat janë projektuar për të përballuar peshë dëbore **80 kg/m² TS 498** dhe shpejtësi ere **102 km/hour (50 Kg/m²) TS 498**. Koeficienti i përçueshmërisë termike për muret e jashtme është **K: 0.34kcal/m²hC (K: 0.39 W/M²K)** dhe **K: 0.59 Kcal/m² hC (K: 0.68 W/m² K)**. Përçueshmëria termike e çatisë është **K: 0.39 Kcal/m² hC (K: 0.45 W/m² K)**.

Koeficienti sizmik **A₀=0.40 (zona sizmike e gradës së I)**. Në varësi të përdorimit dhe zonës së ndërtimit koeficienti i rëndësisë së godinës varion **I=1-1.5**. Koeficienti i peshës së ngarkesës së përkohëshme **n = 0.3-0.6**.

PROJEKTIMI-STATIK: TS EN 1993-1-1, 1-2, 1-8+AC, (EUROCODE 3), TS 11372, TS 498, TS 648, TS 6793, TS EN 1991-1-1-3, 1-1-4 (EUROCODE 1), TS EN 1998-1 (EUROCODE 8), IMO- 01.R-01/2005, Sipas rregullores së ndërtesave të ndërtuara në zonat sizmike – 2007.

MATERIALI: DX51D+Z (~St 37) Erdemir Quality no 1311, S250GD+Z Erdemir Quality no 1325, S320GD+Z Erdemir Quality No 1332 , S350GD+Z (~St 52) Erdemir Quality No 1335, standard DIN EN 10346-00, çelik i galvanizuar me veshje zinku.

STANDARTET PËRKATËSE

Lidhja e elementëve të paneleve me profilin H dhe të këtyre të fundit me çatinë bëhet nëpërmjet bullonave të galvanizuara. DIN 960-961, DIN 935-F,8.8

Termoizolimi: TS 825, Rregullorja e Izolimit Termik (8.05.2000)

Izolimi Akustik: TS 187 and TS 854 (DIN 4109)

Rezistenca ndaj Zjarrit: TS 1263, DIN 4102, TS EN 13501-1, Rregullorja e mbrojtjes nga zjarri – 2002

Izolimi i mureve është i përshtatshëm për zonat klimatike të nivelit të 4 (K:0.40 W/m² K). Dhe çatia për zonat klimatike të nivelit 2 (K:0.40 W/m² K).